

**T & C sh.p.k.**

*(Vlerat janë në Lek)*

---

**T & C SH.P.K.**

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

**PËRMBAJTJA**

	<b>FAQE</b>
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 22

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	19,389,810	21,494,717
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	11,571,372	15,450,548
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6,27	30,280,390	30,565,796
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	6,546,360	12,647,306
Inventarë	8	6,449,672	6,572,847
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>74,237,604</b>	<b>86,731,214</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	9	72,414,362	53,383,001
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>72,414,362</b>	<b>53,383,001</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>146,651,966</b>	<b>140,114,215</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra	10	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	11	21,028,968	59,764,638
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12,27	36,826,434	7,291,807
Detyrime tatimore	13	665,940	5,640,382
Parapagime të arkëtuara	14	12,694,877	12,694,877
Të tjera detyrime	15	17,893,061	10,674,422
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>89,109,280</b>	<b>96,066,126</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Llogari të pagueshme afatgjata nga palët e lidhura	16,27	1,528,925	1,528,925
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>1,528,925</b>	<b>1,528,925</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>90,638,205</b>	<b>97,595,051</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i nënshkruar		200,000	200,000
Rezerva ligjore		20,000	20,000
Fitime të mbartura		42,299,164	3,100,623
Fitimi i ushtrimit		13,494,597	39,198,541
<b>Totali i kapitalit</b>	17	<b>56,013,761</b>	<b>42,519,164</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>146,651,966</b>	<b>140,114,215</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Performancës**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	91,496,350	793,269,691
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	8,397,971	7,046,873
<b>Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime</b>		<b>(45,722,501)</b>	<b>(711,257,626)</b>
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	20	(31,220,433)	(680,817,650)
2) Të tjera shpenzime	21	(14,502,068)	(30,439,976)
<b>Shpenzime të personelit</b>	22	<b>(24,458,235)</b>	<b>(21,863,210)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(22,745,534)	(20,448,349)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,712,701)	(1,414,861)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(12,992,036)	(13,527,025)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(42,256)	(2,800)
<b>Shpenzime financiare</b>	25	<b>(794,075)</b>	<b>(6,592,186)</b>
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(311,773)	(7,064,524)
2) Shpenzime të tjera financiare		(482,302)	472,338
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>15,885,218</b>	<b>47,073,717</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	26	<b>(2,390,621)</b>	<b>(7,875,176)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(2,390,621)	(7,875,176)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>13,494,597</b>	<b>39,198,541</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>13,494,597</b>	<b>39,198,541</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

T & C sh.p.k.

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim /Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2017</b>	<b>200,000</b>	<b>20,000</b>	<b>(16,546,151)</b>	<b>19,646,774</b>	<b>3,320,623</b>
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				39,198,541	<b>39,198,541</b>
Transferim në fitime të pashpërndara			19,646,774	(19,646,774)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>200,000</b>	<b>20,000</b>	<b>3,100,623</b>	<b>39,198,541</b>	<b>42,519,164</b>
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				13,494,597	<b>13,494,597</b>
Transferim në fitime të pashpërndara			39,198,541	(39,198,541)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>200,000</b>	<b>20,000</b>	<b>42,299,164</b>	<b>13,494,597</b>	<b>56,013,761</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i T & C Sh.p.k. më \_\_\_\_\_, dhe janë firmosur si më poshtë:

Hartues i Pasqyrave financiare

**Bledar Trebicka**  
Administrator

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	<b>13,494,597</b>	<b>39,198,541</b>
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime zhvleresimi	2,554,933	2,214,153
Shpenzime amortizimi	12,992,035	11,312,872
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
<b>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</b>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	10,265,528	(34,975,766)
Rënie/(rritje) në inventarë	123,175	(3,179,606)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(6,956,846)	3,186,329
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	(3,784,316)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>32,473,422</b>	<b>13,972,207</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(34,578,329)	(21,860,133)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(34,578,329)</b>	<b>(21,860,133)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Hua të arkëtuara		(84,321,000)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	-	<b>(84,321,000)</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>(2,104,907)</b>	<b>(92,208,926)</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	21,494,717	113,703,643
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>4 19,389,810</b>	<b>21,494,717</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

“T & C” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ne vitin 11.11.2009. në përputhje me Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare.

Shoqëria ka nipt K92326018D. Selia e shoqërisë është Rruga Nacionale Fushe Kruje - Vore, km 1, zona kadastrale nr. 1934, me numer pasurie 34/34, Durrës.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100 kuota me vlerë nominale 2,000 LEK për një vlerë totale 200,000 LEK.

T & C Sh.p.k është një shoqëri shqiptare , e krijuar nga ortakët:

- C.O.M.A.R., që zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë;
- Trema Tech që zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është Z. Bledar Trebicka.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje, blerje, import-eksport të makinerive të ndërtimit dhe pjesëve të tyre të këmbimit.

Në 31 dhjetor 2018 shoqëria ka 11 punonjës.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2016 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2017.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2016.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

#### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

##### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.



### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### **2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

### **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që

maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Euro/LEK	123.42	132.95
USD/LEK	107.82	111.10

### **3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale. Kuotat klasifikohen si kapital.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

## 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

### 3.4. Aktive afatgjata materiale

#### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*(Vlerat janë në Lek)*

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

### **3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatuueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### **3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

### **3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksat e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

**3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
<b>Mjete monetare në bankë</b>	<b>17,987,186</b>	<b>20,521,875</b>
Në lekë	1,862,005	3,057,243
Në monedhë të huaj	16,125,181	17,464,632
<b>Mjete monetare në arkë</b>	<b>1,402,624</b>	<b>972,842</b>
Likuiditete në udhëtim	-	-
	<u><b>19,389,810</b></u>	<u><b>21,494,717</b></u>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare	14,785,525	18,664,701
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(3,214,153)	(3,214,153)
	<b><u>11,571,372</u></b>	<b><u>15,450,548</u></b>

**Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim**

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim gjatë vitit 2018:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Gjendja më 1 Janar	3,214,1583	1,000,000
Rimarrje për vitin 2018	-	-
Zhvlerësimi për vitin 2018		2,214,153
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b><u>3,214,153</u></b>	<b><u>3,214,153</u></b>

**6. Llogari të arketueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë të arketueshme nga palet e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të arkëtueshme nga Trema Tech	5,768,098	5,768,099
Të arkëtueshme nga Comar SAS	(601,843)	-
Të arkëtueshme nga Canzo BLB	7,414,107	6,702,632
Të arkëtueshme nga Trema Engineering 2	4,542,458	7,494,945
Të arkëtueshme nga T&C Kosovë	45,283	45,283
Të arkëtueshme nga ortakët	13,112,287	10,554,837
	<b><u>30,280,390</u></b>	<b><u>30,565,796</u></b>



**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
TVSH e arkëtueshme	6,535,360	12,232,806
Garanci	11,000	11,000
Paradhënie për punonjësit	-	403,500
	<u><b>6,546,360</b></u>	<u><b>12,647,306</b></u>

**8. Inventari**

Inventarët më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Produkt i gatshëm	5,267,960	5,391,117
Lëndë e parë	1,181,730	1,181,730
	<u><b>6,449,693</b></u>	<u><b>6,572,847</b></u>

## 9. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri/Pajisje	Automjetet	Instrumente / vegla pune	Paisje Kompjuterike	Të Tjera	Totali
<b>Kosto</b>						
Gjendja më 1 janar 2017	36,988,848	7,773,056	2,574,994	573,848	111,032	48,021,778
Shtesa	10,344,937	10,911,894	36,912	566,390	-	21,860,133
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>47,333,785</b>	<b>18,684,950</b>	<b>2,611,906</b>	<b>1,140,238</b>	<b>111,032</b>	<b>69,881,911</b>
Shtesa	23,421,271	9,245,516	1,292,399	619,142	-	34,578,329
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	2,554,933	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>70,755,056</b>	<b>25,375,534</b>	<b>3,904,305</b>	<b>1,759,380</b>	<b>111,032</b>	<b>101,905,307</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
Gjendja më 1 janar 2017	3,619,415	1,096,765	225,218	223,275	21,365	5,186,038
Amortizimi i vitit	7,530,227	3,192,224	476,108	92,773	21,541	11,312,873
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>11,149,642</b>	<b>4,288,989</b>	<b>701,326</b>	<b>316,048</b>	<b>42,906</b>	<b>16,498,911</b>
Amortizimi i vitit	8,692,764	3,470,936	542,703	247,549	38,084	12,992,036
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>19,842,406</b>	<b>7,759,925</b>	<b>1,244,029</b>	<b>563,597</b>	<b>80,990</b>	<b>29,490,947</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>						
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>36,184,143</b>	<b>14,395,961</b>	<b>1,910,580</b>	<b>824,190</b>	<b>68,126</b>	<b>53,383,000</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>50,912,650</b>	<b>17,615,608</b>	<b>2,660,277</b>	<b>1,195,783</b>	<b>30,042</b>	<b>72,414,360</b>

**10. Hua afatshkurtër**

Huatë afatshkurtëra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua afatshkurtër nga ortaku	-	-
	<u>-</u>	<u>-</u>

**11. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të pagueshme tregtare	21,028,968	59,764,638
	<u>21,028,968</u>	<u>59,764,638</u>

**12. Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura**

Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura paraqesin detyrimet më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime ndaj Comar SAS	-	-
Detyrime ndaj ortakeve	30,238,741	704,115
Detyrime ndaj Trema Tech	6,587,692	6,587,692
	<u>36,826,433</u>	<u>7,291,807</u>

**13. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	275,841	276,980
Tatim në burim	17,331	8,100
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	245,767	239,840
Tatim fitimi	127,001	5,115,462
	<u>665,940</u>	<u>5,640,382</u>

**14. Parapagime të arkëtuara**

Parapagime të arkëtuara paraqiten më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime të arkëtuara	12,694,877	12,694,877
	<u><b>12,694,877</b></u>	<u><b>12,694,877</b></u>

**15. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime ndaj punonjësve	15,393,091	8,174,452
Detyrime të tjera	2,499,970	2,499,970
	<u><b>17,893,061</b></u>	<u><b>10,674,422</b></u>

**16. Llogari të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura**

Llogari të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura paraqiten më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Te pagueshme ndaj Comar SAS	1,528,925	1,528,925
	<u><b>1,528,925</b></u>	<u><b>1,528,925</b></u>

**17. Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërise është 200,000 LEK i zotëruar 50% nga C.O.M.A.R Srl dhe 50% nga Trema Tech Sh.p.k.

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në LEK)	2,000	2,000
<b>Kapitali i nënshkruar</b>	<u><b>200,000</b></u>	<u><b>200,000</b></u>

Shoqëria ka fitime të mbartura më 31 dhjetor 2018 në vlerën 42,299,164 Lek.

**18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave	58,808,796	731,604,123
Të ardhura nga shitja e sherbimeve	32,687,554	61,665,568
	<u><b>91,496,350</b></u>	<u><b>793,269,691</b></u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2018</u>
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Qarkullim i tatueshëm	100,114,093
Ndryshimi ne parapagime te marra nga klientet	(219,772)
Faturime paraqitur si ulje shpenzimesh	-
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>99,894,321</b>
Sipas Kontabilitetit	99,894,321
<b>Diferenca</b>	<u><b>-</b></u>

**19. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Te ardhura nga komisionet	5,783,873	7,046,873
Te ardhura nga rivleresimi/shitje e aktiveve	2,565,300	-
Te ardhura te tjera	48,798	-
	<u><b>8,397,971</b></u>	<u><b>7,046,873</b></u>

**20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, materialeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Materiale të parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Mallra e aksesorë	30,002,393	612,766,835
Shpenzime për transportin	1,150,802	68,050,815
	<b>31,153,195</b>	<b>680,817,650</b>

**21. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Blerje energji, avull,ujë karburant	776,368	588,111
Shpenzime qeraje	648,000	17,235,910
Mirëmbajtje dhe riparime	2,770,717	3,014,634
Sigurime	7,830	77,280
Shpenzime noteriale dhe financiare	250,211	515,416
Shpenzime udhetime e dieta	1,678,334	341,224
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	-	57,843
Pjese kembimi	2,844,082	3,143,841
Taksa të ndryshme	1,526,998	5,465,717
Shpenzime të tjera	4,066,766	-
	<b>14,569,306</b>	<b>30,439,976</b>

**22. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Shpenzime për paga	22,745,534	20,448,349
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,712,701	1,414,861
	<b>24,458,235</b>	<b>21,863,210</b>

Numri i punonjesve më 31 dhjetor 2018 është 11.

**23. Shpenzime konsumi dhe amortizimi**

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit përfshijnë shpenzimet e konsumit dhe amortizimit dhe provizionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	12,992,036	11,312,872
Provizione për vitin 2017	-	2,214,153
	<u><b>12,992,036</b></u>	<u><b>13,527,025</b></u>

**24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Gjoka të ndryshme	42,256	2,800
	<u><b>42,256</b></u>	<u><b>2,800</b></u>

**25. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për interesa	(312,048)	(7,584,180)
Të ardhura nga interesat	275	519,656
Humbje nga këmbimet valutore	(482,302)	(26,105,448)
Të ardhura nga këmbimet valutore	-	26,577,786
	<u><b>(794,075)</b></u>	<u><b>(6,592,186)</b></u>

**26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	15,885,218	47,073,717
Total shpenzime të panjohura	<b>52,256</b>	<b>5,427,457</b>
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	-	2,214,153
Shpenzime të tjera	52,256	3,213,304
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>15,937,474</b>	<b>52,501,174</b>
Humbje fiskale e mbartur	-	-
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>2,390,621</b>	<b>7,875,176</b>
	<b>13,494,597</b>	<b>39,198,541</b>

**27. Transaksionet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

## Bilanci kontabël

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Të arkëtueshme		
Të arkëtueshme nga Trema Tech	5,768,098	5,768,099
Të arkëtueshme nga Comar Sas	-	-
Të arkëtueshme nga Canzo BLB	7,414,107	6,702,632
Të arkëtueshme nga Trema Engineering	4,542,458	7,494,945
Të arkëtueshme nga T&C Kosovë	45,283	45,283
Të arkëtueshme nga ortakët	13,112,287	10,554,837
	<b>30,882,233</b>	<b>30,565,796</b>
Detyrime		
Detyrime ndaj Comar SAS	601,843	1,528,925
Detyrime ndaj ortakëve	30,238,741	704,115
Detyrime ndaj Trema Tech	6,587,692	6,587,692
	<b>37,428,276</b>	<b>8,820,732</b>



	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
<b>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</b>	
<b>Shitje palëve të lidhura :</b>	
Trema Engineering 2	10,410,900
	<u>10,410,900</u>
<b>Blerje nga palët e lidhura:</b>	
COMAR SAS	1,260,993
BLEDAR TREBICKA	648,000
CANZO BLB	1,798,138
COMAR Commerciale	7,521,791
	<u>4,459,922</u>

**28. Angazhime dhe pasiguri***Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen perfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

**29. Ngjarje pas datës së Bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

---